



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 06.04.2023

Nr: 52

Ora: 15:00

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 46, DATË 04.04.2023 TË DEPOZITUAR NGA Z.  
ÇLIRIM HOXHA**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 06.04.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Z. Çlirim Hoxha;

**OBJEKT:** Kundërshtim i vendimit nr. 19, datë 29.03.2023 të KZAZ-së nr. 72 të bashkisë Devoll, qarku Korçë

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, shkronja "c", 124, 133-136 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

### Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
2. Në zbatim të parashikimeve të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit nr. 01, datë 18.01.2023 për “Përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është depozituar në datën 27.03.2023, në KZAZ nr. 72 të bashkisë Devoll dokumentacioni i z. Çlirim Hoxha për tu regjistruar si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për Kryetar të njësisë së qeverisjes vendore.
3. Me vendimin nr. 19, datë 29.03.2023, KZAZ nr. 72 e bashkisë Devoll, njofton z. Hoxha se në rastin e shqyrtimit të kërkesës së tij, nuk është arritur të merret vendimi për regjistrim, pasi rezultati i votimit nga anëtarët e KZAZ-së ishte 3 (tre) vota *pro* dhe 3 (tre) vota *kundër*.
4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore z. Çlirim Hoxha ku pretendon se:
  - Dokumentet e dorëzuara nga ana e subjektit janë të plota, të dorëzuara brenda afatit ligjor dhe në përputhje me kërkesat ligjore;
  - KZAZ nr. 72, bashkia Devoll, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 71/3 të Kodit Zgjedhor, sepse nuk ka verifikuar 5% të listës mbështetëse;
  - Nëse KZAZ do të kishte konstatuar mangësi në dokumentacion, do të duhej ta kishte pasqyruar këtë fakt në një raport të detajuar, ku duhet të isha thirrur si palë e interesuar gjatë hartimit të raportit;
  - Në vendimin nr. 19, datë 29.03.2023 shihen votimet *pro* dhe *kundër* të anëtarëve të KZAZ-së nr. 72 por nuk ka asnjë fjalë në formë arsytimi pse kanë votuar *kundër* 3 (tre) prej anëtarëve të komisionit;
  - Kërkon shfuqizimin e vendimit nr. 19, datë 29.03.2023 të KZAZ nr. 72, Devoll dhe regjistrimin e tij si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për kryetar bashkie në bashkinë Devoll.

5. Kërkesa ankimore iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Ilirjan Rusmali. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 06.04.2023, ora 15:00. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, pala ankimuese z. Çlirim Hoxha si dhe anëtarët dhe sekretarja e K.Z.A.Z nr. 72, Bashkia Devoll.
6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
- Kërkesën ankimore nr. 46, datë 04.04.2023;
  - Vendimin nr. 19 datë 29.03.2023 të KZAZ-së nr. 72, Devoll;
  - Librin e Protokollit të KZAZ-së nr. 72.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

#### **KAS-i konstatoi:**

1. Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor nr. 72, bashkia Devoll ka marrë në shqyrtim dokumentacionin e kandidimit për kandidatin e propozuar nga zgjedhësit, z. Çlirim Hoxha në datat 27-29.03.2023. Duke qenë se kandidati nuk dispononte mandat personi të zgjedhur nga zgjedhjet pararendëse, në dokumentacionin e depozituar ishin përfshirë lista me nënshkrimet e zgjedhësve që mbështesin kandidimin me gjithsej 395 nënshkrime.
2. Procedura ligjore e verifikimit të dokumentacionit parashikon se lista me nënshkrimet e zgjedhësve merret në shqyrtim nga KZAZ-ja për të vërtetuar, nëse zgjedhësit mbështetës janë zgjedhës të të njejtës zonë zgjedhore, apo jo. Ky verifikim bëhet nëpërmjet kontrollit rastësor të 5 për qind të identiteteve të përfshira në listë. Kuadri ligjor (udhëzimi i Komisionerit nr.1, datë 18.01.2023) nuk ka përcaktuar metodologjinë e verifikimit, gjë që do të thotë se KZAZ-ja ka hapësirë diskreciale për të zgjedhur vetë metodën për përmbushjen e detyrimit.
3. Pohimet në seancë të anëtarëve dhe të sekretares së KZAZ-së nr. 72 provuan, se kryerja e kësaj procedure është sabotuar për shkak të debatit të shkaktuar midis anëtarëve nga ndërhyrja në këtë procedurë e kandidatit të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, i cili i ka paraqitur KZAZ-së një numër prej 8 (tetë) dekaratash noteriale, me të cilat kontestoheshin nënshkrimet e hedhura në formular për 16 (gjashtëmbëdhjetë) zgjedhës.

4. Procedura e verifikimit të listës së zgjedhësve mbështetës është publike. Në të lejohej të marrin pjesë përfaqësuesit e subjektit zgjedhor ose komitetit nismëtar që ka depozituar kërkesën dhe/ose përfaqësuesit e subjekteve të tjera zgjedhore. Por hapat e procedurës janë të përcaktuar në mënyrë precize (neni 9 i udhëzimit të Komisionerit nr. 1, datë 18.01.2023):
- a) Administrata e KQZ-së/KZAZ-së përzgjedh në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve që mbështesin subjektin zgjedhor përkatës të kopjes së formularit tip të nënshkrimeve.
  - b) Administrata e KQZ-së/KZAZ-së verifikon nënshkrimin e kandidatëve **duke përcaktuar nëse nënshkruesit janë zgjedhës me vendbanim në zonat zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit.**
  - c) Numri i nënshkrimeve të rregullta pjesëtohet me numrin që përfaqëson 5% të të gjitha nënshkrimeve të paraqitura. Numri që del nga ky pjesëtim shumëzohet me numrin e nënshkrimeve të paraqitura. Rezultati që del nga këto veprime përfaqëson numrin e nënshkrimeve të rregullta në listën e paraqitur.
- ç) Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve të rregullta është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor.
5. KZAZ-ja nuk ka kompetencë lëndore dhe as kapacitet që të diskutojë dhe as të vendosë lidhur me çfarëdolloj pretendimi për falsifikim të listës. Ndërprerja e procedurës së verifikimit me sondazh sipas ligjit dhe devijimi në çështje që nuk janë kompetencë e KZAZ-së përbën mospërbushje të rregullt të detyrës nga ana e anëtarëve që e kanë shkaktuar këtë devijim. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së propozohen në detyrë nga partitë politike, por, nga momenti i emërimit, ata bëhen zyrtarë zgjedhorë, të cilët i nënshtrohen vetëm ligjit dhe hierarkisë institucionale dhe duhet të demonstrojnë pavarësi nga urdhërat, porositë apo kontrolli partiak në përmbushjen e detyrës.
6. Nisur nga shpjegimet e dhëna në seancë nga ana e kryetarit, sekretares dhe anëtarëve të KZAZ-së që ishin të pranishëm, KAS-i krijon bindjen se lista prej 395 zgjedhësish e depozituar nga komitetit nismëtar i z. Çlirim Hoxha ishte formuar në 100% të përmbajtjes me emra zgjedhësish

të zonës zgjedhore, duke plotësuar kushtin e kërkuar nga ligji që kandidatura të mbështetet nga një listë zgjedhësish prej jo më pak se 1 për qind të totalit të listës së zgjedhësve të zonës. Parregullsitë e pretenduara (16 identitete zgjedhësish), pavarësisht se nuk mund të ishin çështje e kompetencës së KZAZ-së, prapëseprap nuk e rrëzonin plotësimin e këtij kushti.

7. Gjithashtu rezultoi e provuar për KAS-in se KZAZ-ja nr 72 ka vendosur, me shumicën e kërkuar të votave, regjistrimin e z. Çlirim Hoxha si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Prova e këtij regjistrimi disponohet në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së nr. 72. Në fletën e këtij libri, ku është protokolluar vendimarrja për këtë regjistrim, jo vetëm është deklaruar rezultati i votimit 4 me 3 në favor të regjistrimit, por anëtarët kanë nënshkruar të gjithë në këtë fletë, duke lidhur nënshkrimin me këtë votim (anëtarët në pakicë, duke bërë dhe shënimin “kundër” për këtë votim). Në pohimet përpara KAS-it, asnjëri nga anëtarët që kishin votuar kundër, nuk e lidhi shënimin “kundër” në krah të nënshkrimit me çfarëdolloj pretendimi lidhur me përmbajtjen e procesverbalit, sikurse nuk mohoi se shënimi i referohej pikërisht votimit dhe rezultatit 4 me 3 në favor të regjistrimit të kandidatit z. Çlirim Hoxha. Sekretarja e KZAZ-së kofirmoi në seancë se rezultati i votimit 4 me 3 ishte deklaruar nga kryetari i KZAZ-së dhe fjalët e tij ishin pasqyruar prej saj në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së.
8. Vendimi nr. 19, datë 29.03.2023 i KZAZ-së nr.72, i cili duhet të reflektonte vendimarrjen sipas librit të protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së është nënshkruar nga 3 anëtarë që kanë qenë pro dhe 3 anëtarë që kanë qenë kundër gjatë shqyrtimit të çështjes. Anëtari i shtatë që ka qenë pro nuk ka nënshkruar, sepse ka braktisur detyrën papritur dhe pa shkak të ligjshëm. Ky fakt nuk e ndryshon vendimarrjen e komisionit. Vendimi nr. 19, datë 29.03.2023 është thjesht dokumenti zyrtar që vërteton këtë vendimarrje. Mungesa e nënshkrimit nga anëtari i shtatë në këtë dokument duhet të ishte kapërcyer me shënimin nga kryetari dhe sekretarja e komisionit, se anëtari në mungesë ka votuar pro regjistrimit.
9. KAS-i konstaton se sekretarja e KZAZ-së nr. 72 jo vetëm në zbardhjen e vendimit, por në përgjithësi në gjithë procedurën e shqyrtimit të kërkesës për regjistrim të kandidatit z. Çlirim Hoxha i është shmangur përmbushjes së rregullt të detyrës. Neni 34 i Kodit Zgjedhor e ngarkon

sekretarin e KZAZ-së me funksione strikt teknike, të cilat ai i ushtron në ndërveprim të ngushtë me kryetarin e KZAZ-së. Sekretari kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KZAZ-ja dhe i vulos ato (shkronja “dh” e nenit 34), regjistron në protokoll vendimet e KZAZ-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara (shkronja “e” e nenit 34), sikurse përgatit, në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KZAZ-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve (shkronja “ç” e nenit 34). Shkresat nr. 36 prot., datë 28.03.2023 dhe nr. 42 prot., datë 02.04.2023, të cilat sekretarja e KZAZ-së nr. 72 i ka përpiluar dhe vulosur në emër të KZAZ-së, kur ligji nuk i jep asnjë tagër përfaqësimi, janë prova të kësaj veprimtarie në kundërshtim me detyrën dhe në tejkalim flagrant të kompetencës.

10. Sjellja abuzive me detyrën në rastin e praktikës për regjistrimin e kandidatit z. Çlirim Hoxha i ka sjellë pengesa të kundërligjshme një subjekti zgjedhor për regjistrimin e kandidatit të tij dhe vetë kandidatit në ushtrimin e një të drejte të rëndësishme kushtetuese, sikurse ka shkaktuar përfshirjen e palëve në një procedurë të tepërt dhe të panevojshme ankimore, me kosto për to. KAS-i i rekomandon KQZ-së që të shqyrtojë incidentin dhe sjelljen abuzive të këtij rasti, për të identifikuar përgjegjësi të mundshme disiplinore dhe për të marrë masat e nevojshme mbrojtëse në shërbim të menaxhimit të rregullt të procesit zgjedhor përgjatë procedurave të mëtejshme ligjore.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 143, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, KAS

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e Kërkesës Ankimore nr. 45, datë 04.04.2023 të paraqitur nga z. Çlirim Hoxha.
2. Detyrimin e KZAZ nr. 72, Devoll, të marrë vendim për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit z. Çlirim Hoxha për Kryetar Bashkie dhe ta depozitojë atë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>	
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>	
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>	<b>(Kundër)</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>	
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>	<b>(Kundër)</b>

## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 46 të paraqitur nga z. Çlirim Hoxha me objekt *“1. Kundërshtimin e vendimit Nr. 19, datë 29.03.2023, ora 10:00 të KZAZ Nr. 72 bashkia Devoll për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për kryetar të qeverisjes vendore Çlirim Fatmir Hoxha”*, ne, anëtarët në pakicë, duke mos qenë dakord me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi të mendimit se KAS nuk duhet të pranonte ankimin e paraqitur nga z. Çlirim Hoxha dhe për rrjedhojë të linte në fuqi vendimin nr. 19, datë 29.03.2023 të KZAZ nr. 72, ndaj paraqesim, në vijim, argumentet tona për këtë qëndrim.
2. Rezulton i provuar fakti se në vendimin e KZAZ objekt shqyrtimi administrativ, nuk është arritur shumica e nevojshme për regjistrimin si subjekt zgjedhor të ankimuesit në cilësinë e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit. Neni 35 pika 2 fjalia e dytë e K.Zgjedhor parashikon se *“Vendimet e KZAZ-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote”*, ndaj për regjistrimin e një subjekti zgjedhor duhen së paku katër vota pro, numër votash ky që nuk është arritur të plotësohet për ankimuesin.
3. Për ne anëtarët në pakicë, shënimet e mbajtura në Protokollin e Mbledhjes nuk janë të tilla që ta bëjnë të qartë vendimmarrjen e KZAZ në lidhje me regjistrimin e ankimuesit si kandidat pasi në fletën e fundit ka nënshkrime vetëm nga dy anëtarë të KZAZ, çka tregon se mbledhja nuk ka qenë në kuorum dhe së dyti edhe fleta e parafundit që është nënshkruar nga të shtatë anëtarët, ka të cituar vetëm vota *“kundër”* ndërkohë që neni 35 pika 3 e K.Zgjedhor kërkon që *“Vendimet e KZAZ-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të komisionit, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën “pro” ose “kundër”, si dhe arsyetimin përkatës”*.
4. Po ashtu, nga vetë Libri i Protokollit, vërehet se KZAZ nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të verifikuar në zbatim të nenit 71 pika 3 të K.Zgjedhor nëse 5 për qind e listës mbështetëse janë zgjedhës të zonës zgjedhore përkatëse apo jo. Nga Libri i Protokollit del qartë që KZAZ ka trajtuar



vetëm një denoncim të ardhur nga një kandidat tjetër i regjistruar për kryetar të Bashkisë Devoll ndaj ankimuesit Çlirim Hoxha dhe për rrjedhojë e ka konsideruar procesin e verifikimit si një procedurë që kryhet me ankim dhe jo kryesisht për shkak të ligjit.

5. Përveç parashikimit të sipërcituar në lidhje me verifikimin e nënshkrimeve mbështetëse, i referohemi dhe neni 9 të udhëzimit nr. 1, datë 18.01.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” që parashikon se:

*“1. KQZ/KZAZ-ja cakton një seancë publike për verifikimin e nënshkrimeve në të cilën marrin pjesë përfaqësuesit e subjektit zgjedhor ose komitetit nismëtar, dhe/ose përfaqësuesit e subjekteve të tjera zgjedhore.*

*2. Në datën dhe orën e përcaktuar nga KQZ/ KZAZ-ja për zhvillimin e seancës, administrata e KQZ-së/KZAZ-së disponon një kopje të formularit tip të plotësuar nga nënshkrimet mbështetëse.*

*3. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së përzgjedh në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve që mbështetin subjektin zgjedhor përkatës të kopjes së formularit tip të nënshkrimeve.*

*4. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së verifikon nënshkrimin e kandidatëve duke përcaktuar nëse nënshkruesit janë zgjedhës me vendbanim në zonat zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit.*

*5. Numri i nënshkrimeve të rregullta pjesëtohet me numrin që përfaqëson 5% të të gjitha nënshkrimeve të paraqitura. Numri që del nga ky pjesëtim shumëzohet me numrin e nënshkrimeve të paraqitura. Rezultati që del nga këto veprime përfaqëson numrin e nënshkrimeve të rregullta në listën e paraqitur.*

*6. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve të rregullta është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor”.*

Nga Libri i Protokollit i KZAZ del qartë që nuk është kryer asnjë procedurë nga këto që parashikon kjo dispozitë, pra nuk asnjë mënyrë verifikimi të ndjekur nga KZAZ.

6. Po ashtu, gjatë shqyrtimit administrativ në KAS, nuk u krye ndonjë procedurë verifikimi e tillë nga administrata e KQZ në mënyrë që të administrohej si provë në KAS.
7. Për ne anëtarët në pakicë, për aq kohë sa procedura e verifikimit të nënshkrimeve nuk është kryer as nga KZAZ, por as nga vetë KAS, atëherë nuk mund të pranohet regjistrimi si kandidat i subjektit ankimues. Mosndjekja e procedurave të parashikuara nga K.Zgjedhor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, sa i përket regjistrimit të subjekteve zgjedhore, çënon parimin e barazisë së armëve.
8. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se kërkesa ankimore e paraqitur nga ankimuesi Çlirim Hoxha është e pabazuar në ligj dhe në prova, ndaj ajo duhej të ishte rrëzuar nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, ndërkohë që duhet të ishte lënë në fuqi vendimi Nr. 19, datë 29.03.2023 i KZAZ Nr. 72.

**Anëtarë: Elvis Çefa, Ledio Braho**